



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštë Upravu  
III- Nr. i prot. 3751 Mö. 30.07.2021  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

## Raporti i Punës Janar-Qershori



**Drejtoria për Kulturë, Rini  
dhe Sport- Rahovec**

## Përbajtja

Hyrje.....	2
Aktivitetet për tremujorin e parë Janar – Mars 2021.....	3
Aktivitetet për tremujorin e dytë Prill – Qershori 2021.....	9
Biblioteka “Sulejman Krasniqi”.....	19
Palestra “Mizahir Isma”.....	22
Stadiumi “Jahja Danuza” .....	23

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin drejtoria janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xerxë, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe.
- Stadiumin "Jahja Danuza" në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën "Mizahir Isma".

Përvec buxhetit të caktuar komunal, drejtoria ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes bashkëpunimit me OJQ, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

### Aktivitetet e DKRS-së për periudhën raportuese të gjashtëmujorit të parë

Janar – Qershori 2021:

Për gjatë këtij gjashtëmujorit të parë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përfunduar aktivitete të planifikuara në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve, duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të Komunës së Rahovcit.

- Në raportin e punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekteve, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së pëgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.

## Aktivitetet për tremujorin e parë Janar – Mars 2021

- Për ndër të manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”, është formuar Këshilli Organizues, nga i cili janë planifikuar organizimi i këtyre aktiviteteve:

- Mbajtja e homazheve dhe nderime për dëshmorët e kombit Nesimi Elshani, Agron Fetahu, Halim Hoti dhe Hilm Krasniqi, të rënë në Brestoc më 27 Janar 1990.
- Mbajtja e manifestimit përkujtimor e kulturor në shkollën e muzikës “Faik Sylka”.
- Mbajtja e homazheve dhe nderimeve për dëshmorin e kombit Sahit Krasniqi në varezat e dëshmorëve – Ratkoc.



## Për nder të 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, janë organizuar një varg aktivitetesh kulturore – artistike dhe sportive:

- Formimi i Këshillit Organizues për nder të ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- Shpallja e njoftimit për regjistrimin e ekipeve, për garat e organizuara për nder të 17 shkurtit.
- Organizimi i lojës miqësore ndërmjet dy kulubeve të futsallit në Rahovec, atij të KFS "Rahoveci" dhe KFS "Rahoveci 2019".
- Mbajtja e homazheve në varezat e dëshmorëve të kombit në Rahovec.
- Mbajtja e programit festiv, organizuar në Shkollën e Muzikës "Faik Sylka" në Rahovec.
- Mbajtja e seances solemne në Kuvendin Komunal të Rahovecit.
- Në kuadër të kësaj dite është organizuar gjithashtu edhe një eksposítë personale e artistit Femi Hoxhës – Fero.



- **Shpallja e Thirrjes Publike për subvencionim të Sportit:**

→ Qëllimi i kësaj thirrje publike është mbështetja financiare për klubet e sportit, OJQ – të dhe sportistët individual, që aktivitetin dhe fushëveprimtarin kryesore e kanë sportin dhe projektet që ndërlidhen me vetëdijesimin dhe përfshirjen e të rinjëve të komunës së Rahovecit në aktivitetet sportive.

- **Formimi i Këshillit Organizues të Festivalit Tradicional Folklorik “Anadrinia Jehon 2021” - me vendim të kryetarit z. Smajl Latifin.**

→ Këshilli ka për detyrë të ndërmarr të gjitha veprimet organizative për mbarrëvajtjen e festivalit, përfshirë seleksionimin e grupeve artistike pjesmarrëse në festival, rregullimin e skenës, përzgjedhjen e juries profesionale për vlerësim, shpërndarjen e ftesave për pjesëmarrësit si dhe ndarrjen e çmimeve të festivalit në natën finale.



- Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport më 20 Janar 2021, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komunitetin Olimpik të Kosovës me president z. Besim Hasani për zhvillimin e aktiviteteve përvitin 2021.



- Pasurimi i Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" - Rahovec, me një fond librар prej 210 tituj të rinj të librave.



→ Kjo u mundësua me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), në një ceremoni tashmë tradicionale që ministria organizon çdo vit.

- Rreth 600 ekzemplar me libra janë dërguar në Ratkoc, ku shumë shpejt pritet të aktivizohet edhe dega e tretë e bibliotekave, në kuadër të hapësirës së Shtëpisë së Kulturës "Jah Hotii".
- Duke pasur parasysh nevojën e ngritjes së lexueshmërisë në vendin tonë, komuna e Rahovecit ka paraparë hapjen e disa degëve të Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi", duke i mundësuar lexuesëve qasje në ambiente sa më të afërtë përfitim të njojurive dhe informacioneve të reja.



- **Është riorganizuar objekti i Qendrës së Kulturës "JAH HOTI" në Ratkoc.**

- Objekti i Qendrës së Kulturës "JAH HOTI" në Ratkoc, ka sallë të madhe për tubime e aktivitete të ndryshme, bibliotekë, zyrat e gjendjes civile (ofiqarisë) e mjedise të përshtatshme brenda, e që së bashku me parkingun dhe hapësirën përreth objektit, i japin funksionalitet, bukurri, shije kësaj hapësire.
- Besojmë se kjo vatër e kulturës do të ofrojë mundësi më të mëdha për të rinxjtë e kësaj ane, si dhe për komunitetin në përgjithësi, ndaj, kemi detyrim të përbashkët që ta mirëmbajmë.



- Ndahet çmimi "Qytetar Nderi i Komunës së Rahovecit" për luftëtarin e lirisë, atdhetarit Tomor Kotorri nga Përmeti i Shqipërisë.

→ Në sallën e mbledhjeve të kuvendit komunal të Rahovecit, në ceremoninë e organizuar nga kryetari i komunës, Smajl Latifi i është ndarë çmimi "Qytetar Nderi i Komunës së Rahovecit", Tomor Kotorri nga Përmeti i Shqipërisë, me motivacionin: "Për meritën e veçanta në ruajtjen e afirmimin e kulturëskombëtare shqiptare".



→ Në kuadër të këtij aktiviteti, nga Shkolla e Mesme e Ulët e Muzikës "Faik Sylka", në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, është organizuar edhe një pike artistike nga orkestra e kësaj shkolle.

→ Pas përfundimit të ceremonisë së ndarjes së çmimit, kryetari i komunës, Smajl Latifi i shoqëruar edhe nga kryetarja e Bashkisë së Permetit Alma Hoxha, Tomor Kotorri si dhe të pranishëm tjerë, kanë bërë homazhe dhe nderime për të rënët e lirisë



## Aktivitetet për tremujorin e dytë Prill – Qershori 2021



- Klubi i Futsallit Rahoveci 2019 dhe KH Rahoveci, siguron inkuadrimin në Superligën e Kosovës.

→ Vullnetit e profesionalizmi i treguar ndeshje pas ndeshje, ata kanë arritur të sigurojnë vend në kategorinë e zhvillimeve të garave më të larta në elitën e sportit kosovar, atë të Superligës së Kosovë.




- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, vazhdon me pasurimin e bibliotekave në komunën e Rahovecit.

→ Me këtë rast, janë ndarë rreth 200 ekzemplar me tituj të librave të rinj për fëmijë dhe të rritur, në bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi", si dhe në nëndegët e bibliotekës në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc.



- Aktivizohen edhe dy Klube të Librave në komunën e Rahovecit në nëndegët e Krushës së Madhe dhe Ratkoc si dhe një Klub tjetër për të rinjë në Rahovec..

→ Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport përnder të Ditës Botërore të Librit, e cila shënohet çdo 23 prill në mbarë botën, ka aktivizuar dy Klube të Librit, që kanë për synim nxitjen e lexueshmërisë, si dhe rritjen e kreativitetit tek fëmijët dhe tek të rinjtë e komunës së Rahovecit.





- Mbështetur në Rregulloren për Subvencionim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka mbështetur finansiarisht 19 (nëntëmbëdhjetë) projekte në sektorin e Sportit dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) në sektorin për Kulturë dhe Rini.

→ Subvencionet janë ndarë në bazë të vlerësimit nga ana e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për OJQ – të dhe Individ në Kulturë, Rini dhe Sport, brenda afatit

të përcaktuar dhe në përpjekje me rregulloren për ndarje të subvencioneve.

- Shuma e përgjithshme e ndarë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2021, ka arritur vlerën totale prej 140.000.oo€.



- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike kanë organizuar garën në nivel komunal në Volejboll.

→ Pjesëmarrës në garë ishin Shkollat të Mesme të Larta të komunës së Rahovecit:

1. SHML "Xhelal Hajda-Toni" nga Rahovci,
2. SHML "12 Maji" nga Ratkoci,
3. SHML "Ukshin Hoti" nga Krusha e Madhe.







- Për ndër të "Javës së Dëshmorëve", Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me OVL –UÇK dhe Q.K.A "Jehona e Anadrinit", ka organizuar këto aktivitete:

→ Homazhe në varrezat e dëshmorëve në Rahovec, vendosja e pllakave në Shtëpitë Bazë të UÇK – së në: Polluzhë, Zatriq, Kaznik dhe Malësi e Vogël.

- Ekspozitë me fotografi nga edicionet e kaluara të festivalit folklorik "Anadrinia Jehon"- 20vjet traditë, ku qëllimi i ekspozitës kishte të bënte me ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave më të mira të trashëgimisë sonë shpirtërore e kulturore.
- Në kuadër të 20-vjetorit të Festivalit Foklorik "Anadrinia Jehon", janë organizuar Lojërat Tradicionale "Kthim në traditë", në fshatin Dejnë.





- **Eshtë mbajtur organizimi për ndër të 22 vjetorit të zhdukjes së profesorit, ideologut dhe politologut Ukshin Hoti.**


→ Ukshin Hoti "u lirua" nga burgu më 16.05.1999 dhe nga ai moment konsiderohet i zhdukur në mënyrë enigmatike. Fati i tij nuk është ndriçuar ende. Forcat serbe i dogjën shtëpinë në vendlindje, duke e dëmtuar rëndë trashëgiminë materiale e shpirtërore të tij. Për shkak të mënyrës se si luftoi e qëndroi dhe martirizimit shembullor të tij, qytetarët dhe autoritetet lokale në Rahovec, me mirëkuptim të familjes, rindërtuan banesën e tij të rrënuar dhe e kthyen në "Shtëpi-muze".



- **Investimet kapitale të Drejtorisë për Kulturës, Rini dhe Sport:**

→ Në kuadër të projektit "Ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në Dejnë", kanë filluar punimet për tribunën e amfiteatrit të festivalit tradicional "Anadrenia Jehon".  
→ Në kuadër të projektit "Investime në Infrastrukturën Kulturore dhe kënde të lojrave për fëmijë", kanë filluar punimet për parkun rekreativ në Hoqë të Vogël.





- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport së bashku me CHWB-në, kanë arritur bashkëpunim për hartimin e projektit “Restaurim i Mullinit të familjes Isaku (Vuçitërna)” në Rahovec, i cili restaurim do të bëhet në kuadër të projektit “Restaurimi i Monumenteve Kulturore Historike”

- Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh DKRS-ja ka mbajtur takim punë me kryetarin e Federatës së Futbollit, z. Agim Ademi, me qëllim të përmirësimit të situatës së klubeve dhe shkollave sportive.

→ Në takim, kryetari i FFK-së z. Ademi tha se do të vazhdojë punën dhe përkushtimin e tij në përkrahjen dhe mbrojtjen e interesave të futbollit në përgjithësi, si dhe do të thelloj bashkëpunimin me nivelin lokal, në aspektin e rritjes së mundësive investuese përmes financimit të përbashkët, me qëllim të rritjes së sukseseve të reja të sportit në vendin tonë.




- Klubi ftballistik iRahovecit “KF. Rahoveci” inkuadrohet në Ligën e Parë, kurse grupmoshat U16 të KB “RAHOVECI”, inkuadrohen në Superligën e Kosovës.



- Për ndër të 1 Qershori - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Arsimit, në objektin e Qendrës Kulturore "Jah Hoti" kanë shfaqur filmin "Wonder".



- Është bërë pranimi i paisjeve kompjuterike, donacion nga OSBE.



- Shkolla e Mesme e Ulët e Muzikës "Faik Sylka" në bashkëpunim me DKRS-në kanë organizuar Festivalin Mbarëkombëtar i Talentëve të Rinjë "DO RE MI – Unë dhe Ti".

- Në ditën e parë të festivalit, morrën pjesë dhe performuan shkolla të shquara të muzikës nga qytete të ndryshme të vendit tonë në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec.
- Në ditën e dytë të Festivalit është organizuar koncerti klasik nga shkolla e muzikës "Prenk Jakova" nga Prishtina në objektin e Shkollës së Mesme e Ulët e Muzikës "Faik Sylka".



- OJQ "Art Studio", në bashkëpunim me Drejtorenë për Kulturë, Rini dhe Sport, kanë organizuar aktiviteitetin kulturor e artistik "Kolonia Ndërkombëtare e Artit" në Rahovec – Edicioni i 20-të.

- Kolonia Ndërkombëtare e Artit ka realizuar eksposítë, me pjesëmarrje të artistëve nga vendet e ndryshme të botës, dhe artistëve të komunës së Rahovecit.



- **Arrihet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjetë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me projektin “Komunat për të rinjtë në Kosovë”.**
  - Projekti i M4Y është grand 2.7 milion dollarësh, në nivel të Kosovës, i siguruar nga Qeveria Japoneze përmes Fondit Zhvillimor Social Japonez (JSDF), dhe i cili administrohet nga Banka Botërore kurse zbatohet nga MAPL.
  - Projekti ka pëe qëllim rritjen e mundësive socio-ekonomike për të rinjtë e cenuara (15-24 vjet) në Kosovë.
  - Përmes këtij projektit komunat e zgjedhura do të adresojnë nevojat socio-ekonomike të të rinjëve, duke financuar iniciativat të cilat burojnë nga vet ata, me qëllim të rritjen e bashkëpunimit midis rinisë dhe qeverive locale, për zgjedhjen e problemeve në komunitet.



## Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi"

- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

Ijatë kësaj periudhe, kemi bashkëpunuar me dashamirë të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtarë të komunës sonë, në mënyrë jë të kemi ngritur të vetëdijës rreth lexueshmërisë.

Biblioteka në tërësi ka ruajtur vazhdimësnë e punës së saj profesionale në shërbim të lexuesve, të atyre përdoruesve që kanë nevoja për shërbime të ndryshme, si në kërkim të librit, në shfrytëzim të sallës dhe shërbimeve të tjera.

### AKTIVITETET PËR MUAJIN JANAR- MARS

- Është bërë pasurimi i bibliotekës me 3 ekzemplar të ri me poezi, me titull "Mall e Dhembje" nga profesor Fetah Berisha.
- Është bërë pasurimi i bibliotekës me 14 ekzemplar të librave nga drejtori i shkollës 12 Maji në Ratkoc.
- Është bërë pasurimi i bibliotekës me 3 ekzemplar të ri, poezi me titull "Lexo mesazhin tim" nga profesor Milazim Bajraj.
- Është bërë pasurimi i bibliotekës me 3 ekzemplar nga Selim Vefa.
- Është bërë pasurimi i bibliotekës me 210 tituj të rinj të librave, e cila është mundësua me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS).
- Komuna e Rahovecit ka paraparë hapjen e disa degëve të Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi", duke i mundësuar lexuesëve qasje në ambiente sa më të afërtë për përfitim të njohurive dhe informacioneve të reja. Prandaj, rreth 601 ekzemplar me libra janë dërguar në Ratkoc, ku shumë shpejt pritet të aktivizohet edhe dega e tretë e bibliotekave, në kuadër të hapësirës së Shtëpisë së Kulturës "Jah Hoti".
- Është bërë pasurimi i bibliotekës me tri tituj të rinj librash nga poeti Hazir Luta i cili dhuroi bibliotekës 64 ekzemplar me libra.
- Është bërë pasurimi i bibliotekës me 20 ekzemplar të librave nga shoqata Shoqata Atdhetare Mbarëkombëtare "Vëllezërit Frashëri" nga Përmeti i Republikës së Shqipërisë.

### AKTIVITETET PËR MUAJIN PRILL- QERSHOR

- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka vazhduar me pasurimin e bibliotekave në komunën e Rahovecit, ku me që rastë është bërë pasurimi i bibliotekës me 207 ekzemplar me tituj të librave të rinj për fëmijë dhe të rritur, në nëndegët e bibliotekës në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc.

- Fëmijët e shoqatës "Hareja", vizituan bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi" duke shënuar kështu simbolikisht Ditën Botërore të Librit. Me këtë rast ata u informuan nga punëtorët e DKRS-së për fondin librar, numrin e lexuesve dhe nevojën që ka njeriu për të lexuar. Fëmijët u interesuan për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me krijimtarinë letrare, shkrimtarët shqiptarë e të huaj, si dhe për veprimtaritë krijuar e botuese. E për nder të kësaj dite shoqata Hareja", na dhuruan një ekzemplar.
  - Nxënësit e SHFMU "Isa Boletinit" së bashku me arsimtarën znj. Donjeta Vucetëerna, vizituan bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi", ku u informuan rrëth ecurisë së bibliotekës. Ata me njohurit dhe dashurit e tyre për librin na ofruan çaste shumë të mira. Është kënaqësi kur shohim nxënës që aq shumë lexojnë të motivuar nga mësueset dhe shkollat e tyre. Biblioteka është një portë e hapur që çdo herë mirëpret dashamirët e librit.
  - Është bërë pasurimi i bibliotekës nga Bashkim Hoti me 10 ekzemplar librash të autorit suedez Ulmar Kviku "Më shumë heroizma se sa gurë". Ky libër hedh dritë mbi disa aspekte të jetës së shqiptarëve që nga koha ilire e deri në ditët tona. Një këndvështrim interesant dhe i bazuar në të dhëna bibliografike, historike si dhe nga përvoja personale e autorit nga vizitat e tij në trojet shqiptare. Libri përmban të dhëna për pushtimet dhe copëtimin e trojeve shqiptare, luftërat dhe përpjekjet e tyre për ruajtjen e identitetit, gjuhës dhe trashëgimisë historike e kulturore. "Më shumë heroizma se sa grurë" përmban të vërtetat tragjike të shqiptarëve, prandaj ia vlen të lexohet.
  - Është bërë pasurimi i bibliotekës me ekzemplar të ri të librit me titull "Arkivi i Luftës" i përgatitur nga autorri Berat Luzha i cili përbanë katër vëllime, ky liber përshkruan në kronologji, pothuajse të gjitha ngjarjet e rëndësishme të plasuara nga Agjencia Shtetërore e Lajmeve "Kosova Press", si dhe materiale tjera arkivore si lajme, njoftime dhe informata të ndryshme që burojnë nga mediet brenda dhe jashtë vendit gjatë periudhës së luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Vëllimet e këtij libri historik, i janë dhuruar kryetarit të komunës së Rahovecit Smajl Latifit, nga autorri Berat Luzha.
  - Për ndrer të 1 qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ku fëmijë të shkolave filllore të komunës së Rahovecit vizituan bibliotekën tone, me që rastë ata kishin mundësi të argëtoheshin me aktivitete të ndryshme si punime, vizatime, këndime, vallëzimet etj.
- 
- **Pasurimi i fondit librar: 347 ekzemplar Janar-Qershori.**
  - **Fondi total i librave në bibliotekë: 19100 ekzemplar.**
  - **Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar: 274 përdorues.**

**Anëtarësia në bibliotekë për muajin Janar – Qershori**

Muaji	Anëtar	Me Pagesë	Gratisë	Libra të lexuar	Djem	Vajza
Janar	229	224	5	686	246	440
Shkurt	61	60	1	321	112	209
Mars	64	60	4	351	139	212
Prill	54	50	4	312	107	205
Maj	59	59	0	375	163	212
Qershori	16	16	0	144	58	86
<b>Gjithsej</b>	<b>483</b>	<b>469</b>	<b>14</b>	<b>2189</b>	<b>825</b>	<b>1364</b>

**Tabela e lexuesve për muajin Janar – Qershori**

Muaji	Shkolla Fillore	Shkolla e Mesme	Studentët	Të tjerët	Djem	Vajza	Gjithsej
Janar	202	19	5	3	96	133	229
Shkurt	48	5	4	4	23	38	61
Mars	46	7	4	7	21	43	64
Prill	45	4	2	3	19	35	54
Maj	49	2	4	4	26	33	59
Qershori	13	1	0	2	8	8	16
<b>Gjithsej</b>	<b>403</b>	<b>38</b>	<b>19</b>	<b>23</b>	<b>193</b>	<b>290</b>	<b>483</b>

**Palestra e Sportit “Mizair Isma”**

Gjatë këtij gjashtë muajit të parë, në palestër janë realizuar aktivitete të shumta sportive, si nga klube të Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtare, ndër aktivitete tjera janë:

**Aktivitetet për muajin janar- mars**

- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketboll ndërmjet KB - Rahoveci dhe KB – Ylli

- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketball ndërmjet KB-Rahoveci dhe KB-Vllaznimi.
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketball nërmjet KB-Rahoveci dhe KB-Prishtina.
- Është zhvilluar ndeshja finale në futsal ndërmjet KFS-Rahoveci 2019 dhe KFS-Liburni (Gjakove).
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Hendball ndërmjet KH-Rahoveci dhe KH-Lepenci (Kaçanik).
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketball ndërmjet KB-Rahoveci dhe KB-Trepqa (Mitrovica).
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Hendball ndërmjet KH-Rahoveci dhe KH-Drita (Gjilan).
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketball ndërmjet KB-Rahovci dhe KB-Vushtrria për Grupmosha U-18.
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Futsall nërmjet KFS-Rahoveci dhe KFS-Mitrovica.
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketball nërmjet KB-Rahoveci dhe KB-Peja.
- Është zhvillua ndeshja kampionale në Fusall ndërmjet KFS-Rahoveci 2019 dhe KFS-Fahri Vraniqi (Gjakove).
- Është zhvilluar ndeshja Kampionale në Hendball ndërmjet KH-Rahoveci dhe KH-Deqani.
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në futsal ndërmjet KFS-Rahoveci dhe KFS-Albaniku (Mitrovica).
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketball ndërmjet KB-Rahoveci dhe KB-Bashkimi (Prizren).
- Janë zhvilluar ndeshje kampionale në Basketball për Grupmoshat U-10, U-12, U-14.
- Janë zhvilluar garat regionale në Basketball, të organizuara nga Shoqata e Pedagogeve të Kultures Fizike.

### Aktivitetet për muajin prilli- qershor

- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Hendball ndërmjet KH-Rahoveci dhe KH-Ulpiana (Lipjan).
- Është organizuar liga unike në Basketball ku kanë marr pjesë ekipet nga Kosova dhe Shqipria: KB-Rahoveci, KB-Prishtina, KB-Goga Basket dhe KB-Tirana.
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Hendball ndërmjet KH-Rahoveci dhe KH-Dukagjini.
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Futsall ndërmjet KFS-Rahoveci 2019 dhe KFS-Rahoveci.
- Janë zhvilluar tre ndeshje kampionale në Basketball për Grupmoshat U-14,U-16, U-18.
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketball ndërmjete KB-Rahoveci dhe KB-Ylli.
- Është zhvilluar ndeshja kampionale në Hendball ndërmjet KH-Rahoveci dhe KH-Samadrexha.
- Janë zhvilluar tre ndeshje kampionale në Basketball për Grupmoshat U-10, U-12, U-14 ,U-16, U-18.
- Janë zhvilluar ndeshja kampionale në play-off në Basketball ndërmjet KB-Rahoveci dhe KB-Ylli (Suhareke).
- Janë zhvilluar ndeshje kampionale në Basketball për grupmoshat e reja në gjysëmfinale U-12.
- Janë zhvilluar garat shkollore ne Volejboll ku morën pjesë Shkollat të Mesme të Larta të komunës së Rahovecit.
- Janë organizuar trunire dhe ndeshje miqësore për ndër Dites së Clirimisë të Komunes së Rahovecit.

Përpos këtyre ndeshjeve, janë zhvilluar edhe aktivitete të tjera të përditëshme, të cilat janë mbajtur në palestër, janë mbajtur stërvitjet të rregullta të klubeve, janë zhvilluar ndeshjet miqësore, si dhe aktivitetet nga OJQ - të ndryshme nga Komuna e Rahovecit.

## Stadiumi i futbollit "Jahja Danuza" Rahovec

Aktivitetet të cilat zhvillohen në stadiumin Jahja Danuza, janë kryesisht stervitje dhe gara futbollistike te Klubeve dhe të grupmoshave te reja të futbollit.

Klubi i futbollit Rahoveci- stervitjet i ka filluar me 25 janar 2021 me veshtirësi të shumta për shkak të gjendjes së renduar të stadiumit.

### Iktivitetet përmirsimi i stadiumit

- Në stadiumin "Jahja Danuza", nuk janë zhvilluar gara sportive, është punuar në përmirsimin e gjendjes së stadiumit
- Janë zhvilluar ndeshjet kampionale në futboll ndërmjet KF-Rahoveci dhe KF-Minatori (Lipjan).
- Janë zhvilluar ndeshjet kampionale në futboll ndërmjet KF-Rahoveci dhe KF-Dushkaja (Gjakove).
- Janë zhvillua ndeshja kampionale në futboll në mes të KF-Rahoveci dhe KF-Dushkaja (Gjakove).
- Janë zhvillua ndeshja kampionale në futboll ndërmjet KF-Rahoveci dhe KF-Sharri (Hani i Elezit).
- Janë zhvillua ndeshja kampionale në futboll ndërmjet KF-Rahoveci dhe KF- Bashkimi (Koretin).

Gjatë këtyre 6 Muajve, ka pasur aktivitete të rregulla, si dhe nuk ka pasur ndërpreje të stervitjeve. Shumica e aktiviteteve të zhvilluara në palestër dhe në stadium janë organizuar pa praninë e shikuesve, sipas rekomendimeve të Ministrisë së Shendetësisë dhe federatave përkatese sportive.

**Vëmendje:** Gjatë këtij gjashtëmuajor (6), janë ndërmarrë veprime të tjera të cilat nuk janë të listuara në raport, janë diskutuar dhe komentuar aktivitetet dhe ide të ndryshme, të cilat i përkasin sektorit të trashëgimisë. Gjithashtu, janë diskutuar disa nga aktivitetet e planifikura në kuadër planprogramit gjashtëmuajor (6) të zyrës për mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve trashëgimore.

Përgjatë angazhimeve ditore gjithnjë përpinqemi që aktivitetet dhe puna të mos ndalet e që bëjmë përpjekje që aktivitetet tonë tē përditshme të përputhen me rregullat dhe masat e vendosura lidhur me pandeminë.

Rahovec, 2021

